

1 E martë, 29 shtator 2020

2 [Paraqitja e parë]

3 [Seancë e hapur]

4 [I dyshuari Haradinaj hyn në sallën e gjyqit]

5 --- Fillon në orën 15.00

6 GJYKATËSI GUILLOU: Mirëdita. Mirë se erdhët të gjithë
7 brenda dhe jashtë sallës së gjyqit.

8 Përpara se të fillojmë, në përputhje me vendimin tim për
9 caktimin e datës për këtë paraqitje të parë, fotografit të
10 gjykatës i lejohet të bëjë fotografi për një minutë e gjysmë.

11 Urdhëroni.

12 Faleminderit. Tani mund të largoheni nga salla e gjyqit.

13 Ju lutem zonja sekretare e gjykatës, paraqitni çështjen.

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: Mirëdita i nderuar gjykatës.

15 Lënda KSC-BC-2020-07, që ka Prokurori i Specializuar kundër
16 Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt.

17 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit.

18 Përpara se t'ju të kërkoj të pranishmëve në sallë që të
19 prezantohen, dua t'ju rikujtoj të gjithëve disa rregulla të
20 cilat duhet të respektohen gjatë gjithë kohës për ecurinë
21 normale të seancës.

22 Ju lutem, siguroni që ta ndizni mikrofonin përpara se të
23 filloni të flisni dhe ta fikni kur të keni përfunduar me të
24 folurin. Flisni ngadalë dhe qartë, duke qenë se bëhet përkthim
25 në gjuhën shqipe dhe serbishte. Prisni pesë sekonda përpara se

1 të më përgjigjeni mua ose ndonjëres prej palëve, apo një
2 pjesëmarrësi, për t'u mundësuar përkthyesve të përfundojnë
3 përkthimin.

4 Ajo që thuhet në këtë seancë transkriptonet në kohë
5 reale, dhe do të reflektohet në një transkript apo
6 procesverbal i cili do t'u vihet në dispozicion palëve dhe
7 publikut pas kësaj seance.

8 Dua t'i rikujtoj palët gjithashtu, se një pjesë e
9 informacionit në këtë çështje është objekt i masave mbrojtëse
10 dhe urdhrave për konfidencialitet. Informacioni konfidencial
11 nuk duhet të nxirret në seancë publike. Nëse një palë ose
12 pjesëmarrës dëshiron të kalojë në seancë private për t'iu
13 referuar një informacioni konfidencial, për këtë duhet t'i
14 paraqesë arsyet.

15 Tani do t'ju kërkoj palëve dhe pjesëmarrësve të
16 prezantohen. Do të fillojmë me Zyrën e Prokurorit të
17 Specializuar. Urdhëroni.

18 ZNJ. BOLICI: Mirëdita. Për Zyrën e Prokurorit të
19 Specializuar të pranishëm janë Prokurori i Specializuar, z.
20 Jack Smith; z. Alex Whiting, Zëvendësprokuror i Specializuar;
21 z. James Pace, ndihmësprokuror; znj. Line Pedersen,
22 administratore e provave dhe e çështjes; dhe Valeria Bolici,
23 kjo jam unë, prokurore në Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

24 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit zonja prokurore.

25 Tani do t'i drejtohem mbrojtjes. Urdhëroni ju lutem.

1 Z. MARTENS: Faleminderit. Për mbrojtjen i pranishëm
2 është Bas Martens, avokat i Hagës, i përfshirë në listën e
3 Mbrojtësve të Specializuar të Dhomave të Specializuara.
4 Faleminderit.

5 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit.

6 I pranishëm është edhe klienti juaj z. Haradinaj, për hir
7 të procesverbalit.

8 Tani do të kaloj te përfaqësuesit e Zyrës Administrative.
9 Zonja Administratore.

10 ADMINISTRATORJA: Mirëdita i nderuar gjykatës.
11 Administratorja Fidelma Donlon.

12 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit zonja Administratore.

13 Dhe për procesverbalin unë jam Nicolas Guillou, gjykatës
14 i vetëm në këtë çështje.

15 Ju lutem ngrihuni në këmbë z. Haradinaj.

16 A mund të na thoni ju lutem emrin e plotë. Pra, emrin dhe
17 mbiemrin.

18 A mund të lutem ta ndezësh mikrofonin. Është ajo pulla në
19 të djathtë.

20 I DYSHUARI HARADINAJ: Nasim Smajl Haradinaj.

21 GJYKATËSI GUILLOU: Datëlindja dhe vendi i lindjes ju
22 lutem?

23 I DYSHUARI HARADINAJ: 21/05/1963, Gllogjan.

24 GJYKATËSI GUILLOU: Shtetësinë ju lutem?

25 I DYSHUARI HARADINAJ: Këtu më keni thirr si shtetas

1 kosovar dhe kam shtetësi kosovare.

2 GJYKATËSI GUILLOU: Dhe në fund, cili është profesioni
3 juaj?

4 I AKUZUARI: Mendoni profesioni i shkollimit?

5 GJYKATËSI GUILLOU: Jo. Në qoftë se për momentin jeni në
6 punë, apo kryeni ndonjë punë. D.m.th., se çka punoni?

7 I DYSHUARI HARADINAJ: Po. Jam jurist i diplomuar. Kry
8 menaxhimin e ujësjellësit në Deçan, se është ujësjellësi në
9 Deçan, dhe zëvendëskryetar i Organizatës së Veteranëve të
10 Luftës, ose nënkryetar, përgjegjës për media. Këtë e bëj në
11 orare kohë pas kohe. Faleminderit.

12 GJYKATËSI GUILLOU: Ju faleminderit z. Haradinaj. Mund të
13 uleni.

14 Tani më lejoni të shpjegoj historikun procedural të
15 çështjes.

16 Më datën 24 shtator 2020, lëshova një fletarrestim kundër
17 të të dyshuarit, pasi u konstatua ekzistencë e dyshimit të
18 bazuar se z. Haradinaj është përgjegjës penalisht për këto
19 vepra penale:

20 Frikësim gjatë procedimit penal, sipas nenit 387 të Kodit
21 Penal të Kosovës;

22 Hakmarrje, sipas nenit 388 të Kodit Penal të Kosovës; dhe

23 Shkelje të fshehtësisë së procedurave, sipas nenit 392 të
24 Kodit Penal të Kosovës.

25 Dhomat e Specializuara kanë juridiksion për ndjekje

1 penale të këtyre veprave, në bazë të nenit 15 të Ligjit për
2 Dhomat e Specializuara.

3 I dyshuari u arrestua në Kosovë më 25 shtator 2020, kur
4 edhe iu dorëzua fletarrestimi dhe u informua për të drejtat e
5 tij. Ai u transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të
6 Specializuara të Kosovës në Hagë më 26 shtator 2020.

7 Z. Haradinaj, përpara se të vazhdojmë, dua të sigurohem
8 se mund ta ndiqni këtë seancë në një gjuhë që e kuptoni dhe e
9 flisni. A mund të më konfirmoni ju lutem, se e kuptoni dhe e
10 flisni gjuhën shqipe?

11 I DYSHUARI HARADINAJ: Po, e kuptoj dhe e flas gjuhën
12 shqipe, dhe po e kuptoj shumë mirë deri tash.

13 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit z. Haradinaj.

14 Me këtë jam bindur që mund t'i ndiqni procedurat në
15 gjuhën shqipe, si gjuhë që e kuptoni dhe flisni në përputhje
16 me nenin 41. Në qoftë se në ndonjë moment gjatë kësaj seance
17 sot, apo gjatë një seance tjetër, nuk mund ta dëgjoni
18 përkthimin apo ka ndonjë problem teknik me përkthimin, atëherë
19 ju lutem të më informoni menjëherë.

20 I DYSHUARI HARADINAJ: Kjo nuk është gjuhë që unë e
21 kuptoj dhe flas, po është gjuha jeme amtare. Unë flas edhe
22 gjuhë të tjera, por kjo është gjuha jeme amtare.

23 GJYKATËSI GUILLOU: Absolutisht pajtohem me ju.

24 Faleminderit z. Haradinaj.

25 Tani më lejoni të shpjegoj qëllimin konkret të paraqitjes

1 së parë për nevojat e të dyshuarit dhe të atyre që na ndjekin
2 nga galeria publike dhe online.

3 Seanca e sotme nuk është gjykim. Nuk janë ngritur ende
4 akuza kundër të dyshuarit. D.m.th., nuk është paraqitur ende
5 aktakuzë nga Prokurori i Specializuar.

6 Në këtë seancë nuk do të paraqiten dhe nuk do të
7 debatohen prova, dhe nuk do të diskutohet dhe as përcaktohet
8 fajësia ose pafajësia e të dyshuarit.

9 Qëllimi i paraqitjes së parë rregullohet me nenin 41 të
10 Ligjit dhe rregullën 55 të Rregullores. Sipas këtyre
11 dispozitave, unë si gjykatës i vetëm duhet të verifikoj:

12 Nëse i dyshuari është i informuar për arsye të arrestimit
13 të tij, përkatësisht për veprat e pretenduara penale dhe për
14 arsyet e mbajtjes së tij në paraburgim; dhe

15 Nëse i dyshuari është i informuar për të drejtat që i
16 takojnë në bazë të Ligjit dhe Rregullores, duke përfshirë të
17 drejtën e tij për ndihmë juridike.

18 Pres nga palët që t'i kufizojnë parashtrimet e tyre
19 brenda kuadrit të këtyre çështjeve, të cilat do t'i adresojmë
20 një nga një. Nëse ndonjëra prej palëve dëshiron të diskutojë
21 ndonjë çështje tjetër që nuk është paraparë shprehimisht në
22 kuadër të kësaj seance të paraqitjes së parë, këtë mund ta
23 bëjnë me anë të parashtrimeve me shkrim. Dhe theksoj se kam
24 marrë një parashtrim prej përfaqësuesit, të mbrojtësit të z.
25 Haradinaj. Këtë parashtrim e kam marrë mu përpara fillimit të

1 kësaj seance.

2 Fillimisht z. Haradinaj, a mund të më konfirmoni se u
3 është dorëzuar fletarrestimi i 24 shtatorit 2020, në gjuhë që
4 e kuptoni dhe flisni?

5 I DYSHUARI HARADINAJ: Po.

6 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit z. Haradinaj.

7 Për të dyshuarin dhe ata që na ndjekin nga galeria e
8 publikut, tani do t'i kërkoj sekretares, ose sekretarit të
9 gjykatës, të lexojë arsyet e arrestimit të z. Haradinaj të
10 paraqitura në fletarrestim.

11 Urdhëro zonja sekretare e gjykatës.

12 SEKRETARJA E GJYKATËS: Faleminderit i nderuar gjykatës.

13 Sipas fletarrestimit:

14 Së pari, ekziston dyshim i bazuar se Nasim Haradinaj
15 është penalisht përgjegjës për orvatje të kryerjes të kryerjes
16 së veprës penale të frikësimit gjatë procedimit penal, në bazë
17 të nenit 387 të Kodit Penal. Konkretisht, ekziston dyshim i
18 bazuar se z. Haradinaj mbajti tri konferenca për shtyp më datë
19 7, 16 dhe 22 shtator 2020, ku ai shpërndau, ose vuri në
20 dispozicion të medias informacion dhe dokumente konfidenciale
21 dhe jopublike që kanë lidhje me punën e Zyrës të Prokurorit të
22 Specializuar. Dhe përmendi me emër disa dëshmitarë të
23 mundshëm, dhe përmendi të dhëna në lidhje me vendbanimin e
24 tyre dhe të dhëna të tjera personale.

25 Kjo sjellje përbën kërcënim të rëndë ose mënyrë tjetër

1 shtrëngimi që e nxit një person të mos jap deklaratë, ose të
2 jap deklaratë të rreme, ose që të mos iu japë informacion të
3 vërtetë Zyrës së Prokurorit të Specializuar dhe/ose Dhomave të
4 Specializuara.

5 Së dyti, ekziston dyshim i bazuar se z. Haradinaj është
6 penalisht përgjegjës për kryerjen e veprës penale të
7 hakmarrjes, sipas nenit 388 të Kodit Penal. Konkretisht,
8 ekziston dyshim i bazuar se z. Haradinaj mbajti tri konferenca
9 për shtyp më datë 7, 16, dhe 22 shtator 2020, ku ai shpërndau,
10 ose ndryshe vuri në dispozicion të medias informacion dhe
11 dokumente konfidenciale dhe jopublike që kanë lidhje me punën
12 e Zyrës së Prokurorit të Specializuar, ku përfshihen emra dhe
13 të dhëna personale të dëshmitarëve të mundshëm, duke i
14 ekspozuar në këtë mënyrë këta individë ndaj kërcënime të
15 mundshme kundër sigurisë së tyre.

16 Kjo sjellje përbën një veprim të dëmshëm me synimin e
17 hakmarrjes për dhënien e informacionit të besueshëm Task
18 Forcës Hetimore Speciale dhe/ose Zyrës së Prokurorit të
19 Specializuar në lidhje me pretendime për kryeje të veprave
20 penale.

21 Së treti, ekziston dyshim i bazuar se z. Haradinaj është
22 penalisht përgjegjës për kryerjen e veprën penale të shkeljes
23 së fshehtësisë së procedurës, sipas nenit 392 të Kodit Penal.
24 Konkretisht ekziston dyshim i bazuar se z. Haradinaj mbajti
25 tri konferenca për shtyp më datë 7, 16 dhe 22 shtator 2020, ku

1 ai shpërndau, ose ndryshe vuri në dispozicion të medias
2 informacion dhe dokumente konfidenciale dhe jopublike që kanë
3 lidhje me punën e Zyrës së Prokurorit të Specializuar, ku
4 përfshihen emra dhe të dhëna personale të dëshmitarëve të
5 mundshëm.

6 Po kështu, ekzistojnë arsye të artikulueshme për të
7 besuar se arrestimi i z. Haradinaj është i domosdoshëm sepse
8 rrethanat konkrete tregojnë se:

9 (i) ekziston rrezik i arratisjes së tij;

10 (ii) se ai ka motivin, mjetet dhe mundësinë për të
11 penguar ecurinë e procedimit penal, ose procedurës; dhe

12 (iii) ai do të përsërisë ose do të orvatet të kryejë
13 përsëri veprën penale.

14 Faleminderit i nderuar gjykatës.

15 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit zonja sekretare.

16 Z. Haradinaj, dua t'ju rikujtoj se kjo nuk është kohë për
17 të kundërshtuar arsyet e arrestimit tuaj, por thjeshtë që të
18 vërtetohet se jeni i informuar për këto arsye.

19 Z. Haradinaj, a mund të konfirmoni që ju kanë informuar
20 për arsyet e arrestimit tuaj?

21 I DYSHUARI HARADINAJ: Po, po. Këto... Jam informu me
22 shkrim, i kam lexu edhe vetë.

23 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit shumë.

24 Dhe a mund të na konfirmoni në këtë kontekst që ju është
25 dhënë mundësia që të kontaktoni një anëtar të familjes apo një

1 person tjetër për arrestimin tuaj?

2 I DYSHUARI HARADINAJ: Jo. Kjo ka ndodh shumë vonë. Diku
3 tri, katër ditë më vonë. Po megjithatë, është kry tash. Ky
4 arrestim është marrë vesh përmes mediave, po për prunje këtu
5 dhe që unë kam mbërri mirë, është marrë vesh më vonë. Veç
6 prëmë kam kontakt me familjen, sepse ashtu janë afru
7 rrethanat.

8 GJYKATËSI GUILLOU: A ju është dhënë mundësia për t'i
9 kontaktuar ata edhe më parë?

10 I DYSHUARI HARADINAJ: Jo, s'më është dhënë mundësia. Pse
11 i kam paralajmëru, se unë numrat nuk kam mujt me i mbajt mend,
12 unë i kam pas në telefon. Ju kam thanë t'i nxjerrin, me më lun
13 se duhet me i nxjerr. Kanë thanë jo, pastaj do të kujdesem na.
14 Kështu që kjo situatë ka shku kështu. Uroj që të jetë e
15 paqëllimtë, po megjithatë kështu ka ndodhur.

16 GJYKATËSI GUILLOU: Pra, në qoftë se ju kuptoj drejt, ju
17 nuk kishit numrat që ju duheshin për t'i kontaktuar ata sepse
18 ishin në telefonin tuaj ato?

19 I DYSHUARI HARADINAJ: Po, ishin në telefonin që ata e
20 sekuestruan, po që ishte i çel. Faktikisht ata mujshin me i
21 pa, por nuk deshtën.

22 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit z. Haradinaj.

23 Tani do t'ju informoj për të drejtat që keni para kësaj
24 gjykate.

25 Ligji për Dhomat e Specializuara dhe Rregullorja e

1 Procedurës dhe e Provave të garantojnë një numër të drejtash.

2 Unë do t'ju lexoj më të rëndësishmet.

3 Së pari, ju prezumoheni i pafajshëm derisa të provohet
4 fajësia jashtë dyshimit të arsyeshëm.

5 Ju keni të drejtë për një gjykim të drejtë dhe publik, në
6 varësi të ndonjë mase të urdhëruar për mbrojtjen e viktimave
7 dhe dëshmitarëve.

8 Keni të drejtën të bëni ankesë kundër ligjshmërisë së
9 arrestimit tuaj dhe të kërkonit rishikimin e vendimeve për
10 paraburgimin tuaj, dhe të bëni ankesë kundër këtyre vendimeve
11 drejtpërsëdrejti në Gjykatën e Apelit.

12 Keni të drejtën që të mos mbaheni i paraburgosur për një
13 periudhë të paarsyeshme para hapjes së çështjes, dhe keni të
14 drejtën të liroheni në qoftë se prokurori nuk e dorëzon
15 aktakuzën kundër jush brenda një viti.

16 Keni të drejtën e gjyqimit brenda një kohe të arsyeshme,
17 ose të liroheni në pritje të gjyqimit në qoftë se plotësohen
18 kushtet relevante.

19 Ju keni të drejtën që të keni një mbrojtës, që t'ju
20 caktohet pa pagesë në qoftë se nuk i keni mjetet e mjaftueshme
21 për të paguar për të.

22 Keni të drejtën të keni kohë dhe lehtësi të mjaftueshme
23 për përgatitjen e mbrojtjes tuaj dhe të komunikoni me
24 mbrojtësin që e keni zgjedhur vetë.

25 Keni të drejtën e ndihmës së një përkthyesi pa pagesë në

1 goftë se nuk e kuptoni apo flisni gjuhën që flitet në gjykatë.

2 Keni të drejtën që të mos detyroheni të dëshmoni kundër
3 vetes, apo të pranoni fajësinë.

4 Po kështu keni të drejtën të qëndroni i heshtur dhe nuk
5 do të nxirret asnjë përfundim negativ nga heshtja juaj.

6 Z. Haradinaj, ju i dëgjuat të drejtat më të rëndësishme
7 që gëzoni si i dyshuar i mbajtur në paraburgim në përputhje me
8 kornizën ligjore të Dhomave të Specializuara. I kuptoni këto
9 të drejta?

10 I DYSHUARI HARADINAJ: I kuptova.

11 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit.

12 Po kështu, dua t'ju informoj se në bazë të nenit 21(5) e
13 Ligjit, ju nuk mund të përfaqësoni veten sepse jeni për
14 momentin në paraburgim. Kështu që është i detyrueshëm
15 përfaqësimi nga një mbrojtës i specializuar. Është detyra ime
16 si gjykatës i vetëm që të siguroj që e drejta juaj për
17 mbrojtës të respektohet.

18 Për këtë qëllim unë kam marrë shënim parashtrimin e
19 Administratores, i cili më informon që është caktuar mbrojtës
20 kujdestar për këtë seancë të paraqitjes së parë. Unë ju
21 informoj që keni të drejtën që të përfaqësoheni nga një
22 mbrojtës i emëruar për të gjithë kohëzgjatjen e procedurës.
23 Dhe në goftë se nuk keni mjete të mjaftueshme për të paguar
24 për mbrojtësin, mund të bëni kërkesë, të deklaroheni i varfër,
25 dhe në këtë rast keni të drejtën që t'ju caktohet mbrojtësi.

1 Emërimi dhe caktimi i mbrojtësve bëhet nga
2 Administratorja, dhe ju ftoj që ju dhe mbrojtësi juaj
3 kujdestar t'i dorëzojnë asaj të gjitha dokumentacionet e
4 duhura. Po kështu i kërkoj Administratores që të përfshijë një
5 dokument në dosjen e çështjes që më informon për vendimet që
6 janë marrë në këtë drejtim.

7 Tani dëshiroj të ftoj Prokurorin e Specializuar që të na
8 informojë për hapat e mëtejshëm procedural, sidomos se kur ka
9 ndërmend të dorëzojë aktakuzën.

10 Unë e di që për momentin mund të mos ketë afate kohore të
11 përcaktuara, të qarta, por dua ta kujtoj prokurorin se ka dy
12 të dyshuar që janë në paraburgim, dhe unë pres që procesi
13 gjyqësor të jetë i drejtë dhe i shpejtë.

14 ZNJ. BOLICI: Faleminderit i nderuar gjykatës.

15 Së pari, desha të sqaroj për transkriptin, që sapo z.
16 Haradinaj u soll në objektin e paraburgimit në Prishtinë, ai
17 kërkoi që të kontaktonte me një avokat të tijin dhe iu dha kjo
18 mundësi, dhe në fakt ka kontaktuar me një avokat.

19 Për sa i përket kërkesës juaj i nderuar gjykatës, desha
20 t'ju përcjell se Zyra e Prokurorit të Specializuar po punon
21 shumë shpejt për të siguruar që të dorëzohet një aktakuzë
22 kundër z. Haradinaj në kohë sa më të shkurtër.

23 Ka disa hapa hetimore që po i ndërmerr zyra jonë për
24 momentin, për të siguruar që të dorëzohet aktakuza së bashku
25 me të gjitha materialet mbështetëse dhe materialet e tjera

1 relevante për të krijuar një dosje të plotë dhe shteruese.

2 Ndër të tjera, zyra jonë është në procesin e mbledhjes së
3 informacionit nga dëshmitarë të shumtë të cilët i kanë
4 përcjellë zyrës tonë se ndjehen të kërcënuar dhe të frikësuar
5 për shkak të arsyeve që janë përmendur për arrestimin e z.
6 Haradinaj. Janë disa hapa të domosdoshëm hetimorë të cilat
7 përfshijnë disa gjësende të sekuestruara si kompjuterë, kamera
8 survejimi dhe mjete elektronike.

9 Po kështu kërkohen edhe disa dosje apo dokumente nga palë
10 të treta, dhe duhet të merren masa për të bërë transkriptimin
11 dhe përkthimin e provave që janë me audio dhe me video.

12 Paraqitjet publike të të dyshuarve në këto javët e fundit
13 duhet të mblidhen gjithashtu dhe duhet të përpunohen në mënyrë
14 që të kemi dokumentacion të plotë.

15 Pavarësisht nga vëllimi i punës që po kryen zyra jonë, ne
16 presim që do të jemi në gjendje të dorëzojmë aktakuzën shumë
17 shpejt, dhe ju sigurojmë i nderuar gjykatës që jemi të
18 përkushtuar për një proces të shpejtë dhe shterues.

19 Faleminderit.

20 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit zonja prokurore.

21 Desha të pyes palët nëse kanë ndonjë çështje urgjente që
22 duan ta ngrenë tani dhe që nuk mund të trajtohet në
23 parashtrime me shkrim. Po kështu i kujtoj palëve që në qoftë
24 se kanë gjëra që kërkojnë nxjerrjen e materialeve
25 konfidenciale, ju lutem na informoni, në mënyrë që të merren

1 masat e duhura.

2 Tani do të filloj me mbrojtjen.

3 Nëse doni të ngrini çështjet që keni ngritur në
4 parashtrimin me shkrim tuajin, atëherë ju lutem bëjeni këtë
5 vetëm për një minutë sepse ne i kemi tashmë me shkrim ato.

6 Z. MARTENS: Faleminderit i nderuar gjykatës.

7 Mbrojtja ka dorëzuar një mocion paraprak për hedhjen
8 poshtë të këtyre akuzave dhe një mocion për lirin e
9 menjëhershëm të klientit tim.

10 Zyra e Prokurorit të Specializuar sapo tha që do të bëhet
11 një proces i shpejtë dhe që aktakuza do të përpunohet shumë
12 shpejt. Megjithatë, unë nuk kam dëgjuar një datë prej tyre. Në
13 qoftë se Zyra e Prokurorit të Specializuar e zgjodhi datën e
14 arrestimit vetë, gjë që ka sjellë në këtë proces që kemi tani
15 dhe klienti im ka përfunduar në paraburgim.

16 Puna që duhet bërë, që sapo përmendi prokurorja, kjo
17 është një punë shumë e madhe dhe është një punë që do të
18 kërkojë shumë javë ose shumë muaj. Kështu që ju duhet të
19 rishikoni akuzat kundër klientit tim.

20 Sepse siç e kam thënë në mocionin tim, dhe që ta kenë të
21 qartë të gjithë ata që janë në këtë sallë gjyqi dhe jashtë
22 saj, klienti im nuk është akuzuar për krime lufte. Ky është
23 një tribunal për krime lufte, kurse klienti im nuk është i
24 akuzuar për krime lufte. Dhe për këtë arsye, në parashtrimin
25 tim që i kam dorëzuar gjykatës, nuk ka kjo gjykatë juridiksion

1 për këto akuza kundër klientit tim, sidomos neni 387 as nuk
2 mbulohet nga juridiksioni i kësaj gjykate. Kjo është një nga
3 shqetësimet më të mëdha dhe një nga akuzimet më të rënda që i
4 janë bërë klientit tim.

5 Dhe për më tepër, sepse nuk dua të përmend të gjitha
6 gjërat që kam përmendur, që i kam paraqitur me shkrim në
7 parashtrimin tim, po përfundoj me këtë, që dua nga ju, i
8 nderuar gjykatës, të vendosni që akuzat nuk janë brenda
9 juridiksionit të Dhomave të Specializuara të Kosovës; të
10 hidhni poshtë akuzat kundër tij; ta lironi menjëherë nga
11 paraburgimi z. Haradinaj me kushte të cilat do të përcaktohen
12 nga ju; dhe t'i jepen z. Haradinajt dhe avokatit mbrojtës të
13 tij të gjitha dokumentet dhe materialet mbështetëse të
14 aktakuzës në gjuhën shqipe dhe angleze, pse deri tani kemi
15 marrë vetëm fletarrestimin dhe dokumentet e transferimit. Po
16 kështu edhe vetëm protokollin për COVID-19 në objektin e
17 paraburgimit.

18 Faleminderit.

19 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit i nderuar mbrojtës.

20 Unë e kam marrë shënim dokumentin që keni dorëzuar ju
21 sot, dhe i kërkoj Zyrës së Prokurorit të Specializuar të japin
22 përgjigjen e tyre ndaj mocionit të mbrojtësit të z. Haradinaj
23 deri të premtën në datën 2 tetor, duke pasur parasysh
24 urgjencën e kësaj kërkesë. Dhe ky është një urdhër me gojë.

25 Nëse doni t'i përgjigjeni ju prokurore mbrojtësit.

1 ZNJ. BOLICI: Në lidhje me kundërshtimin e juridiksionit,
2 vura re se mbrojtësi nuk përmend ekzistencën e dy dispozitave
3 shumë të rëndësishme në Ligjin për Dhomat e Specializuara dhe
4 Zyrën e Prokurorit të Specializuar, që japin bazat e
5 juridiksionit të Dhomave për krimet për të cilat është
6 arrestuar z. Haradinaj.

7 Për sa i përket dorëzimit të dokumentacionit, ne do t'i
8 dorëzojmë ato brenda afateve të caktuara.

9 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit zonja prokurore.

10 Z. Haradinaj, keni ndonjë çështje që doni ta ngrini në
11 lidhje me arrestimin, transferimin apo paraburgimin tuaj?

12 I DYSHUARI HARADINAJ: Këtu mendoni për me tregu sesi kam
13 ardh, si më kanë arrestu, apo diçka tjetër? Apo mendimin tem
14 për thirrje këtu?

15 GJYKATËSI GUILLOU: Nuk ka nevojë të më thoni sesi
16 ndodhën të gjitha. Kjo është një mundësi për ju që të ngrini
17 ndonjë çështje. Nëse ka pas ndonjë problem gjatë transferimit,
18 arrestimit, apo keni ndonjë problem në paraburgim tani.

19 I DYSHUARI HARADINAJ: Jo, jo. Ato janë bë në konform të
20 urdhnave të juaja. Ashtu siç i keni marrë ju, prandaj unë dhe
21 jam këtu. Nuk janë sjell keq. Me përjashtim se unë nuk e
22 arsyetoj arrestimin dhe s'muj e kuptoj. Dhe nëse më lejohet me
23 bisedu, me fol, unë kam disa konkluzione të mijat, që pastaj
24 ju i merrni vendimet e juve në bazë të asaj çka unë e them.
25 Sepse unë mendoj që do të jetë fjala e fundit që e flas tash.

1 Nëse ma lejoni, unë e kam shkru pak shumë, po është
2 shkurt. Nuk besoj që zgjat mbi dy, tri minuta.

3 GJYKATËSI GUILLOU: Zakonisht kjo paraqitje e parë është
4 kryesisht për t'ju informuar unë për të drejtat tuaja, dhe nuk
5 është për të diskutuar thelbin e çështjes. Pra, nuk është
6 momenti për ta bërë këtë prezantim.

7 Po në qoftë se është diçka që doni absolutisht ta thoni,
8 mund ta thoni tani z. Haradinaj.

9 I DYSHUARI HARADINAJ: Unë mendoj se e drejta jeme është
10 shprehja e mendimit të lirë, prandaj ju nëse doni me ma uzurpu
11 këtë sikur edhe ma keni uzurpu, mundeni me ma uzuptu.

12 Dhe unë në këtë moment po ju them, nuk e kam njoft këtë
13 gjykatë, nuk e njoh dhe s'kam me e njoft këtë gjykatë.

14 Përkundrazi mandatit 5-vjeçar që ju ka dhanë Parlamenti jem
15 dhe tash jeni me afat të skaduar mbas 2 gushtit. Kaq. Nëse
16 s'më lëni më me bisedu, unë s'foli më.

17 Dhe kjo ka qenë çdoherë publike. Nuk a kanë diçka që e
18 kam thanë sot, nesër, po e thojmë që 15 vjet. Kemi 150 000
19 nënshkrime nga popullata, bile të dërguara dhe në Bruksel, që
20 jemi kundër kësaj gjykate.

21 Faqezinjtë tonë deputetë, për poste të veta, rroga të
22 veta, e kanë sjellë popullin këtu që sot me e arrestu, me thy
23 Kushtetutën tonë, me ia vjedh qytetarin në mes të atyjit edhe
24 pas skadimit të afatit të juve.

25 Prandaj e ndiej veten që jam padrejtsisht këtu. Thjesht

1 keni thy Kushtetutën e vendit tim, keni thy çdo ligj njerëzor,
2 keni thy të drejtën e mendimit të lirë.

3 Mendimin për gjykatën edhe në 1 milion vjet, 500 milion
4 vjet, s'muj të ma hekni mu, as 500 mijë njerëzve që mendojnë
5 si unë.

6 Nëse për këtë është e dënueshme, atëherë midis Evrope le
7 të dënohem për mendimin e lirë. Unë për mendimet e lira jam
8 dënuar në moshën 15-vjeçare nga regjimi i Slllobodan
9 Milosheviçit. Baba, fëmija, familja komplet. Edhe nuk i kemi
10 ra pishman dhe si bimë apet. Luftojmë, kemi luftu për të
11 drejtën minimale njerëzore, mendimi i shprehjes së lirë. Kaq.

12 Dhe nga këtu unë më nuk dua të bisedoj, meqenëse e pashë
13 që nuk je në disponim të më lësh ta lexoj këtë faqe që kam
14 shkru.

15 GJYKATËSI GUILLOU: Faleminderit z. Haradinaj për
16 komentet.

17 Do të keni kohë të mjaftueshme për të ngritur të gjitha
18 çështjet shqetësuese për ju, në veçanti në hapat pasardhës.
19 Kështu që mos u ndieni i acaruar, do të keni kohën e nevojshme
20 për të shpalosur dhe për të dhënë të gjitha mendimet tuaja.

21 Së fundi, dua që t'ju informoj që në ditët në vijim, unë
22 do të lëshoj disa vendime, në mënyrë që të mund të
23 planifikohet procesi i rregullt i seancave të mëparshme.

24 Nuk do të jap vendim për klasifikimin e dokumenteve. Dhe
25 gjithashtu do të jap një vendim edhe sa i takon gjuhës së

1 punës së proceseve.

2 Z. Haradinaj, dua t'ju them që ju mund të kundërshtoni
3 ndalimin tuaj në përputhje me rregullën 57, dhe kjo do të
4 trajtohet me parashtrime me shkrim.

5 Në përputhje me nenin 41 dhe rregullën 57, unë do ta
6 rishikoj paraburgimin tuaj të paktën një herë në dy muaj, ose
7 me kërkesë të prokurorit ose me iniciativën time.

8 Duke e marrë parasysh llojin e veprës, dhe duke marrë
9 parasysh gjithashtu edhe dispozitat e nenit 57(1), do të doja
10 që t'i kërkoja Prokurorit të Specializuar që të parashtronte
11 aktakuzën sa më shpejt të jetë e mundur.

12 Ky është fundi i seancës së sotme.

13 Faleminderit Administratores. Faleminderit përkthyesve.
14 Faleminderit të gjithë të pranishmëve edhe për personelin e
15 sigurimit.

16 Seanca përfundon këtu.

17 --- Seanca përfundon në orën 15.38

18

19

20

21

22

23

24

25